

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7176
E hënë, 29 prill 2024
Çmimi 0.50

Vëmendje! Ndryshime taktike në gjeopolitikën serbe

FAQE 6-7

Shkruan:
Hajdin ABAZI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

REGJISTRIMI I DIASPORËS: ÇFARË PËRFITON KOSOVA?

FAQE 4



I dërgojnë në Kosovë mbi një miliard euro çdo vit, por numri i saktë i kosovarëve që jetojnë jashtë vendit nuk dihet. Llogaritet të jenë rreth 700 mijë, por gjatë

një procesi që u përcoll me shumë kritika vite më parë, doli se diaspora e Kosovës ka rreth 400 mijë persona. E për t'u ditur numri i vërtetë, diaspora i ka dy

mundësi për pjesëmarrje në regjistrimin e popullsisë: përmes familjarëve që jetojnë në Kosovë apo online përmes platformës ediaspora.rks-gov.net

OSMANI: SERBIA PO E SHKEL MARRËVESHJEN PËR TË ZHUKURIT, S'PO I HAP ARKIVAT

F. 3



ALI AHMETI NGA STRUGA: MË 8 MAJ TA VULOSIM FITOREN PËR FRONTIN EVROPIAN

F. 3

AKTUALE



BE-ja: PRESIM PROCES ZGJEDHOR DEMOKRATIK NË MAQEDONINË E VERIUT MË 8 MAJ

F. 2

EDITA TAHIRI NË KONVENTËN E PARTISË SË ILIR METËS: ËSHTË LIDER QË I DUHET SHQIPËRISË

F. 3

LDK-ja U VENDOS "VIJA TË KUQE" TË GJITHA PARTIVE POLITIKE PËR KOALICIONE PARAZGJEDHORE

F. 5

EKONOMI



MUSTAFA: KOSOVA ME RITJE TË NGADALËSUAR EKONOMIKE, QEVERIA TË KOORDINOHET ME ALEATËT

F. 8

TRAJTIMI I PUNËTORËVE TEKNIKË VAZHDON TË JETË SHQETËSUES

F. 8

EKONOMI



FITOJNË BALLKANI E LLAPI, DËSHTON DRITA

F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Irani e paraqet një dron të ri "kamikaz"

TEHRAN, 28 PRILL - Ushtria iraniane e ka paraqitur të dielën një dron të ri sulmues, i cili është i dizajnuar për të fluturuar drejt në cak për të shpërthyer, sikurse lloji i dronit që po përdoret nga Rusia në luftën në Ukrainë. Sipas agjencisë shtetërore të lajmeve, droni i ri iranian - emri i të cili nuk është zbuluar publikisht ende - është i ngjashëm me dronin rus Zala Lancet, i cili u prodhua për herë

të parë në vitin 2020. Irani pretendon se ka bërë përparime të mëdha në prodhimin e dronëve në vitet e fundit. Dronët e prodhuar nga Irani janë përdorur shumë nga forcat ruse prej se Moska e nisi pushtimin e Ukrainës më 2022. Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Kanadaja vendosën sanksione të reja kundër Teheranit të enjten, duke e vënë në shënjestër prodhimtarinë dhe eksportin e

dronëve të këtij vendi, pas sulmeve ajrore iraniane kundër Izraelit. Irani i ka kundërshtuar ashpër këto sanksione. Teherani e sulmoi Izraelin si përgjigje ndaj një sulmi të dyshuar izraelit në një konsullatë iraniane në Damask të Sirisë, ku u vranë disa persona, përfshirë dy komandantë të lartë të Trupave të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit.



Senatorët amerikanë e paralajmërojnë Tbilisin se ligji për "agjentët e huaj" mund t'i prishë raportet

WASHINGTON, 28 PRILL - Një grup dypartiak prej 14 senatorëve amerikanë e kanë paralajmëruar në një letër kryeministrin e Gjeorgjisë, Irakli Kobakhidze, se synimi i vendit të tij për ta risjellë një "ligj për agjentët e huaj të stilit rus" mund të shkaktojë ndryshime në politikën amerikane karshi Tbilisit.

Në letër, të dërguar më 26 prill dhe të cilën e siguroi Zëri i Amerikës, senatorët thanë se janë "tejet të shqetësuar që po minohen synimet transatlantike të Gjeorgjisë".

Kjo letër u dërgua pak pasi Komiteti amerikan i Helsinkit i bëri thirrje partisë në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, ta tërheqë projektligjin për "agjentët e huaj" dhe i kërkoi Tbilisit të "largohet nga kjo rrugë e dëmshme".

Qeveritë perëndimore dhe grupet për të drejtat e njeriut e kanë dënuar projektligjin kontrovers të Gjeorgjisë për "agjentët e huaj", për të cilin thonë se është kopje e një ligji të ngjashëm rus, të cilin Moska e përdor për t'i luftuar zërat kritikë në vend.

Mijëra gjeorgjiane kanë dalë nëpër rrugë për të protestuar kundër këtij projektligji. Ky legjislacion kishte nxitur protesta masive edhe kur u soll për herë të parë vitin e kaluar, duke e detyruar qeverinë ta tërheqë



projektligjin. Mamuka Mdinardze, kryetar i grupit parlamentar të Ëndrrës Gjeorgjiane, tha këtë muaj se partia e ka ndër mend ta risjellë këtë projektligj, i cili do t'i detyronte organizatat jofitimprurëse dhe mediet, të cilat financohen nga jashtë dhe të cilat janë të angazhuara në aktivitete "politike", të raportojnë për aktivitetet e tyre para autoriteteve.

Projektligji parasheh që autoritetet të kenë kompetenca të mëdha mbikëqyrëse si dhe dënime të mundshme për vepra të paspecifikuara penale.

Ëndrra Gjeorgjiane tha se projektligji i ri është i njëjtë me atë që u tërhoq vitin e kaluar, vetëm se e ka një ndryshim: Termi "agjentët e huaj" është zëvendësuar nga një term më i tërthorët, "organizatat që ndjekin interesat e pushteteve të huaja".

Senatorët amerikanë i hodhën poshtë pretendimet e qeverisë gjeorgjiane se ky legjislacion është i barasvlerëshëm me ligjin amerikan që u kërkoi qytetarëve amerikanë të regjistrohen si agjentë të huaj, nëse ata i përfaqësojnë interesat e një pale të huaj në Shtetet e Bashkuara.

Ish-kryeministri i Gjeorgjisë, Irakli Garibashvili, kryetari i Ëndrrës Gjeorgjiane, tha më 27 prill se letra e senatorëve "bazohet në keqkuptime".

Zyrtarët e Ëndrrës gjeorgjiane kanë ngulur këmbë se legjislacioni ka për qëllim të sjellë transparencë në një kohë tensionesh së larta. "Vendi ynë, fatkeqësisht, ende përballet me sfida. Sfida kryesore është pushtimi i huaj i 20 për qind të territorit tonë. Trupat ruse qëndrojnë në territorin e okupuar, edhe pse ka edhe rreziqe të tjera në vendin tonë", tha Garibashvili.

Ndjesia antiruse mund të jetë e fuqishme shpesh në Gjeorgji. Trupat ruse ende e kontrollojnë rreth një të pestën e territorit të Gjeorgjisë, shumicën e të cilit e morën gjatë luftës së vitit 2008.

Leximi përfundimtar i projektligjit do të hidhet për debat më 17 maj.

Presidentja e Gjeorgjisë, Salome Zurbishvili, tha për BBC kohë më parë se ajo do të përdorë veto kundër projektligjit, nëse ai kalon në leximin e dytë.

Zurbishvili tha se shqetësimi i saj kryesor është se projektligji në fjalë është "tamam kopje e ligjit të [presidentit rus Vladimir] Putin". Megjithatë, Zurbishvili tha se partia në pushtet Ëndrra Gjeorgjiane ka mjaft deputetë për ta rrëzuar veton e saj.

Ambasadori i Bashkimit Evropian në Gjeorgji e ka kritikuar rikthimin e projektligjit, duke thënë se ai nuk është në përputhje me vlerat e bllokut, të cilit Tbilisi dëshiron t'i bashkohet.

Human Rights Watch gjithashtu e ka kritikuar këtë legjislacion.

Gjeorgjia ka qenë e zëshme në synimin e saj për t'iu bashkuar BE-së, dhe vitin e kaluar e mori statusin e vendit kandidat pasi qeveria u tërhoq nga përpjekja e parë për ta kaluar këtë projektligj, pas protestave të mëdha.

BE-ja: Presim proces zgjedhor demokratik në Maqedoninë e Veriut më 8 maj

BRUKSEL, 28 PRILL - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shkup, David Geer, tha të shtunën se blloku pret të ketë zgjedhje demokratike dhe të rregullta në Maqedoninë e Veriut më 8 maj, kur do të mbahet raundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale si dhe zgjedhjet parlamentare njëkohësisht.

Kandidatja opozitare Gordana Silanovska-Davkova e fitoi rundin e parë të zgjedhjeve presidenciale të mërkurën bindshëm po pamjaftueshëm për ta shmangur rundin e dytë, ku më 8 maj do të përballet me

presidentin aktual, Stevo Pendarovski.

Geer tha se shpreson se pjesa e dytë e fushatës zgjedhore dhe zgjedhjet e dyfishta do të kalojnë në një frymë demokratike dhe paqësore, siç e vlerësoi OSBE/ODIHR rundin e parë në raportin e saj preliminar. "Më e rëndësishmja është... në raundin e parë zgjedhjet u zhvilluan në një atmosferë përgjithësisht të qetë dhe demokratike. Dhe, ne shpresojmë shumë që në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale, si dhe në fushatën për zgjedhjet parlamentare, të



gjithë të angazhohen për ta përfunduar procesin përmes mesazheve pozitive në fushatë", tha Geer.

Ai nuk i ka komentuar zërat se mund të ketë bojkot të zgjedhjeve presidenciale në raundin e dytë me qëllim që të mos arrihet pragu i daljes për 40 për qind, për ta dështuar procesin. "Çdo çështje tjetër politike që lidhet me zgjedhjet, shpresoj ta kuptoni që nuk do ta komentoj në këtë fazë. Është në dorën e qytetarëve të vendosin për të ardhmen e vendit", shtoi ai.

Osmani: Serbia po e shkel marrëveshjen për të zhdukurit duke mos i hapur arkivat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka akuzuar Serbinë se po vazhdon ta shkelë një marrëveshje të Brukselit mes dy vendeve për personat e pagjetur, duke i shpërfillur kërkesat e Kosovës për hapjen e arkivave të policisë dhe ushtrisë serbe në lidhje me mijëra persona të zhdukur me forcë gjatë luftës së viteve 1998/1999 në Kosovë.

Duke folur pas homazheve të Memorialit për të Pagjeturit më 27 prill në Prishtinë, Osmani tha se "edhe sot Serbia vazhdon të bëjë krim të dyfishtë, sepse njëherë e kreu krimin, pastaj bëri çmos ta fshehtë atë, duke i fshehur gjurmët e krimit edhe 25 vjet më vonë".

Në Kosovë më 27 prill shënohet Dita Kombëtare e të Zhdukurve me Forcë gjatë luftës. Rreth 6 000 njerëz u zhdokën gjatë luftës së fundit, prej të cilëve mbi 1 600 janë ende të pagjetur.

"Përkundër faktit se kryetari i komisionit qeveritar, Andin Hoti, i ka dërguar letra Serbisë disa herë, duke i kërkuar që... të hapen arkivat për të dhënat e brigadave policore dhe ushtarake, për të cilat

ka dëshmi që kanë marrë pjesë në masakra, por edhe në operacione pas luftës për fshehjen e trupave - Serbia akoma nuk bëhet e gjallë në përgjigjen e këtyre kërkesave dhe vazhdon ta shkelë këtë marrëveshje të arritur në Bruksel", tha Osmani.

Kosova dhe Serbia, një vit më parë, u pajtuan për Deklaratën e përbashkët për personat e zhdukur, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Zotimet që u bënë me këtë deklaratë, përfshijnë: qasje të plotë në informacione të besueshme, mes tyre edhe ato me status të klasifikuar; vënie në dispozicion të të gjitha dokumenteve me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur, si dhe punë të përbashkët përmes një komisioni të kryesuar nga Bashkimi Evropian.

Një vit pas, asgjë prej këtyre në praktikë, të gjitha vetëm në letër.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" ditë më parë se Deklarata e përbashkët, e miratuar nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në maj të vitit



2023, "nuk po zbatohet ende". Stano theksoi se Deklarata nuk është ligjrisht e detyrueshme, por shtoi se BE-ja kërkon nga palët të angazhohen "në mënyrë konstruktive" në kuadër të

dialogut për të arritur pajtueshmëri për termat e referencës.

Gjatë luftës në Kosovë janë vrarë rreth 13 000 njerëz, janë zhvendosur mbi 800 000, ndërsa

janë zhdukur rreth 6 000, prej të cilëve rreth 1 600 janë ende të pagjetur.

Qindra trupa të shqiptarëve të vrarë të Kosovës janë gjetur në varrezat masive në Serbi.

Ali Ahmeti nga Struga: Më 8 maj ta vulosim fitoren për Frontin European

STRUGË, 28 PRILL - Para qytetarëve të Strugës të dielën ishte kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, me bashkëpunëtorë, të cilët i falënderoi për mbështetjen duke kërkuar që më 8 maj të vuloset fitorja madhështore për të ecur vendi përpara. "Kam ardhur sot me një qëllim, që t'ju falënderoj për mbështetjen shumë të madhe këtu në Strugë, për misionin në vazhdimësi. Mekanizmi i cili i shpërndan rrezet përmbytjesore të platformave janë shefat e shtabeve, garda mobilizuese për ta depërtuar synimin e qëllimit. Platforma 'Po Europës, jo Rusisë' ishte e jona. Opozita donte vetëm shkatërrimin e BDI-së. Të dyja i



kuptoj sepse ua ka zënë dielli, mirëpo janë njerëzit që vendosin

a do të rrënohet BDI-ja apo jo. 24 prilli e vërtetoi, e konfirmoi dhe

afirmoi që BDI-ja nuk rrënohet, por tanimë kjo BDI punon dhe vepron në kuadër të së cilës janë dhe tetë subjekte të tjera dhe ky front më 24 prill u përball me opozitën VLEN dhe më 8 maj përballëmi me VMRO-në. Misioni ynë vazhdon. Ne duam që vendi të jetë anëtar i plotë në BE, sepse alternativë tjetër nuk kemi. Vendi ka më shumë nevojë për paqe, siguri, stabilitet, sepse jo larg nesh zhvillohen luftime të mëdha dhe Evropa është në shqetësim dhe ka dhënë urdhër për mobilizim të teknologjisë ushtarake. Më 8 maj duhet të fitojë forca që ka për mision anëtarësimin e vendit në BE si e mbyllim me sukses

anëtarësimin në NATO, që përfitojnë të gjithë qytetarët", ka thënë Ahmeti.

Jetoni Shaqiri, koordinator i zonës, falënderoi shefat e shtabeve dhe të gjithë aktivistët dhe bashkëpunëtorët që ishin ditën e zgjedhjeve dhe garantoj para kryetarit të BDI-së, Ali Ahmeti, se më 8 maj do të jenë më të suksesshëm se më 24 prill. Ndërkohë kandidatët për deputetë Arjeta Alla, Atixhe Ajroja dhe Muhamed Halili theksuan se Fronti Evropian, para së gjithash, paraqet sfidë, përkushtim dhe detyrim dhe se njësi numër 5 meriton më shumë për një përfaqësim dinjitoz ku 8 maji do ta vulosë fitoren e madhe.

Edita Tahiri në konventën e partisë së Ilir Metës: Është lider që i duhet Shqipërisë

TIRANË, 28 PRILL - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka mbajtur fjalim sot Konventën e Partisë së Lirisë në Tiranë, e cila udhëhiqet prej ish-presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. Ajo tha se Ilir Meta është lider që i duhet Shqipërisë dhe ka dhënë arsyet për këtë deklaratë. "Shqipëria ka burra dhe gra që ua sjellin shpresën shqiptarëve. E ka Ilir Metën lider vizionar, patriot, i

vendosur dhe i guximshëm. Pse unë kam besim te Ilir Meta. Po jua shpjegoj. Kur Kosova u kërcënua pas luftës, para pak vitesh, nga skemat serbo-sllave që kërcënonin copëtimin e një pjese të Kosovës, pra veriun dhe ndryshimin e kufijve, Ilir Meta, president i republikës, nuk pyeti për çmim as për post, por doli në mbrojtje të Kosovës, e kundërshtoi hapur ndryshimin e kufijve. Çfarë pamë ne? Pamë me një anë që presidenti i

Shqipërisë po mbron Kosovën që e kemi fituar me gjak, në anën tjetër kryeministri Rama po copëton Kosovën. Nuk ishte vetëm Rama me Vuçiqin, me presidentin e Kosovës, Thaçin, por nuk lejuam. I mposhtëm dëmtuesit e Kosovës. Kështu do të mposhtni edhe ju që jeni forcë sot me një lider kaq të madh dhe kaq të vendosur. Do të bëheni uragan i ndryshimit të madh që i duhet Shqipërisë dhe shqiptarëve", ka thënë Tahiri.





Regjistrimi i diasporës: Çfarë përfiton Kosova?

I dërgojnë në Kosovë mbi një miliard euro çdo vit, por numri i saktë i kosovarëve që jetojnë jashtë vendit nuk dihet. Llogaritet të jenë rreth 700 mijë, por gjatë një procesi që u përcoll me shumë kritika vite më parë, doli se diaspora e Kosovës ka rreth 400 mijë persona. E për t'u ditur numri i vërtetë, diaspora i ka dy mundësi për pjesëmarrje në regjistrimin e popullsisë: përmes familjarëve që jetojnë në Kosovë apo online përmes platformës ediaspora.rks-gov.net

PRISHTINË, 28 PRILL - I dërgojnë në Kosovë mbi një miliard euro çdo vit, por numri i saktë i kosovarëve që jetojnë jashtë vendit nuk dihet. Llogaritet të jenë rreth 700 mijë, por gjatë një procesi që u përcoll me shumë kritika vite më parë, doli se diaspora e Kosovës ka rreth 400 mijë persona. E për t'u ditur numri i vërtetë, diaspora i ka dy mundësi për pjesëmarrje në regjistrimin e popullsisë: përmes familjarëve që jetojnë në Kosovë apo online përmes platformës ediaspora.rks-gov.net. Pse është i rëndësishëm regjistrimi?

Përmes regjistrimit Kosova kupton, numrin, përbërjen dhe shpërndarjen e diasporës. Shteti, po ashtu, do të ketë të dhënë për moshën, gjininë, të dhëna rreth arsimimit, profesionin, gjininë dhe të dhëna

rreth statusit socio-ekonomik të diasporës.

Këto të dhanë ndihmojnë që të përshtaten shërbimet konsulllore, programet kulturore dhe iniciativat ekonomike për diasporën. "Nëse ne duam të hapim një konsullatë të re, duhet të kemi një bazë të mirë të të dhënave dhe në lokacionin ku duam ta hapim konsullatën e re ta kemi evidencën se kemi nevojë ta hapim konsullatën në atë lokacion. Njëjtë vlen edhe për hapjen e ndonjë qendre kulturore", ka deklaruar zëvendësministria e diasporës, Liza Gashi.

Pika më e rëndësishme është shfrytëzimi i diasporës për t'i avancuar raportet diplomatike me shtete ku është i përqendruar numri më i madh i diasporës.

Procesi i regjistrimit ka filluar më 5

prill dhe do të vazhdojë deri më 17 maj.

Brenda kësaj periudhe secili qytetar i Kosovës mund të bëhet pjesë e procesit.

Fillimisht duhet hapur platforma ediaspora.rks-gov.net. Pastaj duhet të plotësohen të dhënat standarde për emrin, mbiemrin komunen e Kosovës etj.

Formulari për diasporën përfshin edhe pyetje të tjera si: Viti i largimit nga Kosova, shteti ku qëndron, arsyet e emigrimit etj.

Mbi të gjitha, ky regjistrim do të jetë i rëndësishëm për ta ditur numrin e qytetarëve në diasporë edhe për shkak të migrimit të lartë në vitet e fundit.

Vetëm në vitin 2022 nga Kosova janë larguar më shumë se 40 mijë persona, kryesisht për qëllime punësimi, raporton "Radio Evropa e Lirë".

Mbi gjysmë milioni qytetarë rezidentë dhe rreth 36 për qind të të gjitha objekteve janë regjistruar në dy javët e para të procesit të regjistrimit të popullsisë në Kosovë, ka njoftuar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK).

Kryeshefi ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, ka theksuar se procesi është duke shkuar "ashtu siç është

planifikuar" dhe "pa sfida madhore". "Deri më tani [21 prill] janë regjistruar 530 000 persona, si dhe mbi 36 për qind e objekteve në Kosovë. Po flasim për popullsinë rezidente në Kosovë. Stafi është stabilizuar këto ditë, ka filluar intervistat në mënyrë masive", tha ai.

Kastrati theksoi, po ashtu, se ky proces është duke u zhvilluar në të gjithë territorin e Kosovës dhe me të gjitha komunitetet, pavarësisht prej paralajmërimeve për bojkotimin e procesit nga komuniteti serb. "Të gjitha zonat janë duke marrë pjesë në regjistrim dhe të gjitha komunitetet janë duke marrë pjesë në regjistrim. Edhe komuniteti serb është duke marrë pjesë në të gjitha zonat dhe komunat. Jo në masë si në zonat e tjera, por ka filluar një regjistrim sadopak në javën e parë dhe presim që të ketë regjistrim edhe në atë pjesë", shtoi ai.

Më 5 prill, kur edhe filloi regjistrimi, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit, kishte thënë se serbët nuk do të mermin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Regjistrimi i fundit i popullsisë në

Kosovë, në vitin 2011, nuk ishte mbajtur në katër komunat në veri, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan – të banuara me shumicë serbe, ndërsa serbët nga komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit, kryesisht e kishin bojkotuar procesin.

Sipas Kastratit, deri më tani katër apo pesë ekonomi familjare kanë refuzuar të regjistrohen. "Jemi duke vazhduar procedurat ligjore dhe të gjithë ata që refuzojnë do të përcillen sipas ligjeve në fuqi", theksoi ai.

Sipas Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, çdo person mund të gjobitet nga 30 deri në 2 000 euro nëse refuzon t'i japë informacionet e kërkuara nga regjistruesi.

Gjobat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro, për biznese.

Liza Gashi, zëvendësministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), shpалosi të dhënat për regjistrimin e diasporës. "Deri më tani kemi 180 000 mijë pjesëtarë të diasporës që janë regjistruar në kuadër të procesit, mbi 50 mijë janë regjistruar në platformën E-diaspora, prandaj u bëj thirrje bashkatdhetarëve të regjistrohen", theksoi ajo.

LDK-ja u vendos 'vija të kuqe' të gjitha partive politike për koalicione parazgjedhore

Prishtinë, 28 prill - Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se ka qenë kryeministri Albin Kurti ai që ka ofruar të shpërndahet Kuvendi dhe PDK-ja i është përgjigjur me një datë, por nuk e mendon se kanë tamam marrëveshje mes vete.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së ka thënë se partia ku ai bën pjesë nuk do të bëjë koalicion parazgjedhor me asnjë parti politike në vend. "S'po them që ka marrëveshje, por Kurti ka ofruar për ta shpërndarë Kuvendin dhe PDK-ja iu ka përgjigjur me një datë për

zgjedhje. Është deklarim publik. PDK-ja e ka emëruar edhe kandidatin për kryeministër. Pra i ka bërë përgatitjet", ka thënë ai. Gashi thotë se me PDK-në e AAK-në janë parti konceptualisht të ndryshme. "Por që kanë marrëveshje nuk po them, por meqë LV-ja po do të ndërtojë argumentin, se të gjithë po bëhen bashkë për t'u rrëzuar, nuk është ashtu. Jemi tri parti të ndryshme. Nuk kemi dhe nuk do të kemi marrëveshje të koalicionit parazgjedhor me asnjë parti politike. Ky është qëndrimi ynë", tha Gashi në emisionin "DPT te Fidani".



Shaip Kamberi lidh koalicion paszgjedhor me PD-në e LPD-në në Bujanoc



BUJANOC, 28 PRILL - Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka njoftuar për nënshkrimin e koalicionit paszgjedhor me Partinë Demokratike dhe Lëvizjen e Progresit Demokratik në Bujanoc.

Kamberi derisa ka shpërndarë disa fotografi nga procesi i nënshkrimit të koalicionit, ka shkruar se ky është një hap i rëndësishëm drejt një bashkëpunimi të fortë. "Ky është hap i rëndësishëm drejt një bashkëpunimi të fortë dhe

të përbashkët për të siguruar një qeverisje të mirë në komunën tonë. Marrëveshja jonë synon luftën kundër diskriminimit, zhvillimin shoqëror, barazinë dhe zhvillimin ekonomik, social e kulturor të komunës së Bujanocit", ka shkruar ai në "Facebook".

Më tutje, ai ka pohuar se "do të vazhdojmë të angazhohemi që të krijojmë një mjedis të hapur dhe demokratik, duke u dhënë rëndësi zgjedhjeve të lira, të drejta dhe transparente, ku çdo

ide dhe opinion ka vendin e tyre". "Për ne, respektimi i votuesve dhe pjesëmarrësve në zgjedhje është i pamohueshëm. Besimi në historinë tonë kombëtare, rëndësia e bashkëpunimit ndërpartiak dhe angazhimi për stabilitetin dhe zhvillimin e komunës sonë janë qëndrime që na udhëheqin në këtë rrugë drejt frontit shqiptar për Bujanocin", ka theksuar ai. Kamberi thotë se "frontin e përbashkët për shqiptarët në komunën e Bujanocit ua kemi borxh çdo qytetari tonë".

LV-ja në Prishtinë akuzon Përparim Ramën, thotë se po planifikon të keqpërdorë një tender në vlerë prej 10 milionë eurosh

PRISHTINË, 28 PRILL - Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Prishtinë, ka akuzuar kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama, se po vazhdon abuzimin e parasë publike. Para gazetarëve u paraqit koordinatori i nënkomiteteve të Qendrës së Prishtinës, Arben Brovina.

Qëllimi i kësaj konference, sipas zyrtarit të LV-së, ishte denoncimi i një tenderi të dyshimtë të cilën planifikon ta realizojë komuna e Prishtinës. Sipas Brovinës, konkretisht bëhet fjalë për kontratën me emër "Programi për ofrimin e

shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në komunën e Prishtinës - SIPA UA 06 2021". "Kjo kontratë kornizë, me kohëzgjatje 36 muaj dhe me vlerë të parashikuar 10.000.000 euro, sipas analizës së ekspertëve tanë të fushës, në shumë pjesë të saj është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, e pamundëson konkurrencën dhe kriteret e kërkuara favorizojnë operatorë ekonomikë të caktuar", ka thënë ai. Gjatë fjalës së tij, Brovina potencoi se kjo

kontratë është vazhdimësi e kontratave të dëmshme të realizuara edhe më parë nga ekzekutivi i Prishtinës. "Kemi të bëjmë me keqpërdorim të parasë publike e në dobi të grupeve dhe individëve të caktuar", është shprehur ai. Në fund, Brovina u bëri thirrje organeve kompetente shtetërore, hetuesisë dhe prokurorisë, ta trajtojnë këtë rast sepse dyshimet janë të bazuara që po tentohet të realizohet një tender i orkestruar me vlerë 10 milionë euro.



Vëmendje! Ndryshime taktike në gjeopolitikën serbe



Shkruan: Hajdin ABAZI

Serbia po bën një ndryshim qasjesh dhe politikash, të cilat, qartësisht shpërfaqin një ndryshim taktik në gjeopolitikë; është ndryshim taktik sepse për shovinizmin serb strategjia gjeopolitike ka qenë thuasht e përcaktuar në anën kundër Perëndimit. Në këndqasjen time, shovinizmi serb ka flirtuar me perëndimin vetëm si përpjekje për të përfituar benefite të ndryshme, por mbi të gjitha për ta lajthitur atë gjoja për përpjekje properëndimore, ndërkohë që me veprime e sjellje dhe politika destruktive në rajon ishte pjesë integrale e gjeopolitikës ruse. Gjithsesi perëndimi i ka ditur ose i ka presupozuar këto manovra politike, por ka ushqyer shpresën se megjithatë mund të atrahohet për t'u futur në gjeopolitikën perëndimore, përmes koncesionesh të ndryshme dhe jo të pakta realisht, përmes anëtarësimit në Këshillin e Evropës (KiE), dhe procesit të integritetit në mekanizmat e BE dhe madje edhe bashkëpunimi me NATO-n. Kjo, sepse është në interesin e perëndimit që të mos lejojë një agresion tjetër në Ballkan që do të ishte një minim i unitetit evropian. Për një kohë, dukej sikur Vuçiq po rikonfigurohej në mënyrë të rafinuar për t'u rrjetëzuar me frymën dhe vlerat perëndimore, por pastaj, nga shtytje të ndryshme, ai nuk mundi të vazhdojë më të ulet në të dyja karriget, dhe kohëve të fundit po vërehet një kundërvënie, si deklarativisht ashtu edhe me veprime, ndaj perëndimit. Kjo bie në sy nga retorika e tij e hapur antiperëndimore, duke i quajtur mashtrues, gënjeshtarë, antiserb, pro-Kosovë etj.

Se shovinizmi serb, në krye me Vuçiq, po përpjek për t'ia hidhte perëndimit, në shumëqëndrime e veprime mund të argumentohet kjo gjithandë në Ballkanin Perëndimor, por sidomos në Kosovë ajo është krejt e hapur. Përderisa në Bosnjë-Hercegovinë ishte Dodik ai që

vepronte si institucion i një shteti, dhe në Mal të Zi tash në emër të Kuvendit e mbase edhe të Qeverisë, në dukje pa ndikim të drejtpërdrejtë nga Beogradi, në raport me minoritetin serb në Kosovë ndikimi i Beogradit ishte krejtësisht i hapur dhe publik. Lista serbe, në vitin 2014, u krijua nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Beogradit dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite të dirigjohet nga atje, duke u thirr në interes të minoritarëve serbë në fakt duke u instrumentalizuar tërësisht në shërbim të interesave shoviniste.

Se sa larg mund të shkojë verbëria shoviniste mund të kuptohet nga përpjekja për të nxitur një kryengritje të minoritetit serb në shtator të vitit 2023, veprim ky i cili jo vetëm cenoi integritetin e Kosovës, lirinë dhe paqen e saj, por edhe vetë NATO-n, pasi që ajo e ka përgjegjësinë për sigurinë e kufijve dhe ishte një agresion i orkestruar pikërisht nga Beogradi dhe erdhi nga brenda territorit të Serbisë.

Pasi kjo tentativë dështoi (me gjithë se ka mjaft mistere se si arritën të tërhiqeshin paq pjesa e mbetur e agresionistëve në Serbi, pra se a ia bëri të mundur tërheqjen Qeveria e Kosovës për të mos shkaktuar një gjakderdhje që i konvenonte realisht vetëm Beogradit dhe në rast se ishte kjo - që ligjërisht jo por politikisht mund të ketë kuptim, atëherë duket se ne nuk e kemi shfrytëzuar këtë sa ka qenë e mundur për t'i treguar botës përgjegjshmërinë tonë për të evituar një kasaphanë; nëse jo nga Qeveria sikurse ajo pretendon, atëherë misterit bëhet edhe më i madh - nga kush? Njësia Speciale e Kosovës nuk arriti t'i ndiqte e t'i kapte? Apo u bë me qëllim evitimi të një ndërhyrje ushtarake serbe - nga kush? Nga KFOR-i, ELJEX-i? Ka pra shumë mungesë të dhënash që të mund të arrihet në një zbardhje të së vërtetës), Perëndimi i bëri trysni të ndryshme dhe të shumanshme Serbisë për arrestimin e terroristëve, duke ia bërë të qartë se nuk tolerohet veprimi agresionist. Dhe Kosova luajti deri diku me këtë kartë. Beogradi u mundua të lë përshtypjen sikur do të ndiqte një rrugë të moderuar në politikë (duke larguar ministrin e brendshëm Vulin). Akti agresionist i shtatorit 2023 do të jetë një gur mëkati që do t'i rëndojë shovinizmit serb,

ose për ta bërë të këndellet ose të plandoset.

Një rrethanë tjetër që pati ndikim ishëm zgjedhjet (janar 2024) në Serbi, të cilat nga perëndimi përgjithësisht e nga BE dhe Gjermania posaçërisht, u kritikuan si të manipuluar, dhe kështu pushteti i Vuçiq u tipizua si jolegitim, dhe kjo ishte një sfidë që e bëri atë të sillej me dinakëri, për t'i treguar perëndimit se ai është "bosi" dhe se ai është që mund të hyjë në transaksione në emër të shtetit serb dhe madje edhe të të gjithë serbëve, porse një "bos" i gatshëm për lëshime e kompromis po qe se do të lihej qetë në pushtet.

Një ndikim kishte, gjithsesi fakti se Kosova ndodhej në prag të votimit në Këshillin e Evropës (KiE), ku edhe u votua pro-pranimi. Përpjekja shoviniste ishte e shumëkrahshme. Qyshkur Vuçiq kishte shpallur një aksion diplomatik, për të penguar Kosovën në integritet ndërkombëtar, e duket se konkretisht ishte në fokus pikërisht anëtarësimi në KiE. Në anën tjetër, u pa se kishte mobilizuar deputetët serbë jo vetëm të Serbisë, por edhe të BeH dhe të Malit të Zi, që të votonin kundër.

Kosova u votua me shumicë të madhe për anëtarësim në KiE. Me këtë rast, në lojë ishin shumë qasje, fërkime dhe tensione të hapura, të fshehura dhe të heshtura. Serbia synonte që përmes mosvotimit pro Kosovës të përfshinte në qerren e vet edhe të tjerë në mosnjohjen e shtetit të Kosovës si realitet dhe do të ishte një fuqizim i pozitave të saj kundër Kosovës. Krahas këtyre rrjedhjavave të drejtpërdrejta, në prapaskenë ishte diçka e madhe, e ndërlidhur me të natyrisht, që duke e lajthitur shumicën evropiane kundrejt Kosovës, t'i krijonte një terren jo vetëm shovinizmit serb por edhe, dhe gjithashtu, gjeopolitikës ruse, pasi që Evropa do të kurthohej në një qëndrim të gabuar, dhe do të binte pre e mashtrimit shekspirian të Beogradit.

Votimi me më shumë se dy të tretat pro Kosovës (nga 171 delegatë, 131 votuan për, 29 kundër dhe 11 abstenime), shpërfaqti një vetëdije të lartë politike të deputetëve evropian sa për shovinizmin serb aq edhe për ndikimin rus i cili është i pakalueshëm në Evropë. Mund të thuhet se ishte, në një farë mënyre, një betejë politike midis dy

gjeostrategjike - asaj perëndimore dhe asaj ruse. Por ka disa indikacione interesante, ata që votuan kundër, krahas serbëve, i bënë një shërbim të gjeopolitikash antiperëndimore, me vetëdije ose jo, gjë që Evropa duhet t'i ketë në vëmendje, sepse me rritjen e trendit të fitoreve në zgjedhje të ekstremistëve të djathtë, në disa raste edhe drejtpërdrejtë nën ndikimin rus, gjendja mund të rrëshqasë në kahun jo të duhur. Tashmë është brengosëse informacioni mbi rrjetin e spiunazhit rus në disa vende të BE-së.

Në këtë mes, lidhur me votimin për në KiE, Kosova kishte bërë aq sa mund të bënte, duke iniciuar çështjen e hektarëve të Manastirit të Deçanit. Për fatin tonë, interesat e Kosovës janë në linjë të njëjtë me interesat e vendeve perëndimore, që prej kursorit të hapur properëndimor dhe demokratik të instaluar qysh në dekadën e fundit të shekullit XX, prej nga u derivua qëndrimi i qartë dhe i pamëdyshje kundër agresionit rus në Ukrainë, dënimit krahas kombeve paqedashëse dhe vënies së masave ndaj Ruisë si preventivë për të ndaluar agresionin e saj, prandaj dhe ishte një mbështetje aq e gjerë. Përndryshe, përtej konditave politike, Kosova ka herë i kishte plotësuar kushtet për anëtarësim në KiE po se po por edhe në BE.

Qëndrimi serb prej Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi kundër anëtarësimit të Kosovës në KiE, u përballë me qëndrimin perëndimor, që është për paqe dhe zgjidhje të qëndrueshme, dhe për t'i shtyrë proceset në këtë drejtim. Pikërisht kjo i tërboi shovinistët. Dështimi i tyre nuk ishte vetëm në votim, por edhe në stilin shovinist serb të mashtrimit, ju dështoi "gënjeshtria serbe". Dhe nga kjo, ata kuptuan se Perëndimi e ka kuptuar dredhinë e tyre politike dhe nuk do të bie në kurthin e tyre. Shantazhi, kërcënimi dhe dredhiti, asnjëra veç e veç e as bashkërisht, nuk pijtën ujë. Perëndimi i tregoi se nuk mashtrohet. Ai mund të ishte tolerant për të krijuar kondita të favorshme për ata që duan të reflektojnë e të ndryshojnë, por kishte një kufi. Krahas kësaj, kërkesat e vazhdueshme për dënimin e terroristëve të shtatorit 2023 e

për më tepër - edhe nisma për rezolutën në OKB për gjenocidin serb në Srebrenicë, janë veprim që po i tregohet Serbisë se aty ku cenohet siguria nuk ka tolerancë më, dhe se krimi, si në rastin e Bosnjës, edhe pas tre dekadash - nuk mbetet i pandëshkuar. I përballur me këtë presion, mbase edhe i ndikuar nga rrethana të tjera dhe aleati gjeostrategjik, Vuçiq ndryshoi sa retorikën aq edhe sjelljet politike.

Një prej përpjekjeve të radhës mund të jetë tërheqja e njohjes nga Mali i Zi, ku ka krijuar një epërsi shovinizmi serb në Kuvend dhe në Qeveri, ndonëse mund të përballet me qëndrimin e faktorit shqiptar në pushtet, sa ta bëjë të rrëzueshme qeverinë me dominancë serbe.

Një tjetër veprim, është ai i destabilizimit të Bosnjë-Hercegovinës përmes Dodik, i cili tashmë haptas po trumbeton një separatizëm, një ndarje të Republikës Serbe nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, kurse Serbia ka qëndrime irredentiste, që punon në çdo mënyrë për të aneksuar territore të shteteve të tjera, nëse jo publikisht, me veprime e nxitje po. Madje, bashkërendimi është publik midis Dodik dhe Putin, Dodik me Vuçiq, dhe kisha Ortodokse Serbe, duke qenë në frekuenca të njëjta tensionnxitëse dhe luftëshkaktuese.

Në të gjitha këto, veprimet janë disa dimensionëshe: kundër vendeve të caktuara të Ballkanit Perëndimor si veprim i drejtpërdrejtë, e në fakt i orientuar kundër Perëndimit dhe pro Ruisë.

Kur Vuçiq shkoi në Paris në prag të votimit në KiE për anëtarësimin e Kosovës (16 prill 2024), dhe u takua me presidentin Macron, u la përshtypja e një përpjekje kundër Kosovës. Shpejt u bë e qartë se kishte edhe një prapaskenë dhe objektiv tjetër - blerjen e aeroplanëve luftarakë. Dhe me sa duket ishte e dobishme për Francën një biznes miliardësh, ndaj dhe i qe pohuar shitja. Vuçiq u kthye si triumfator: do të humbte në KiE, por do të fitonte ushtarakisht. Por shpejt u bë e qartë edhe publikisht, se SHBA i kishte refuzuar shitjen e avionëve të tillë luftarak Serbisë. Dhe Franca, u tërhoq, duke vënë ca kondita, të cilat në rrethanat e tashme nuk mund t'i plotësojë Serbia.

Edhe njëherë, kështu, u

Posta e Kosovës vë në qarkullim pullat postare "Sali Çekaj, heroi i Kosovës"

PRISHTINË, 28 PRILL - Posta e Kosovës, përmes Filatelistë së saj, ka vënë në qarkullim postar emisionin e jashtëzakonshëm të pullave postare "Sali Çekaj, hero i Kosovës".

Emisioni i pullave postare për Sali Çekajn, hero i Kosovës, është pjesë e shënimit përkujtimor në qytetin e Shtutgartit, ku Sali Çekaj për vite me radhë ka dhënë kontribut të pamohueshëm

për çështjen e Kosovës. Ky emision i pullave postare bëhet në 25-vjetorin e rënies së tij në Betejën e Koshares në shenjë nderimi për figurën e "Veteranit" dhe për të gjithë ata që ranë për liri. "Posta e

Kosovës vazhdon të nderojë personalitete atdhetare me imazhe të pullave postare të Filatelistë së saj, me të cilat do ta afirmojë shtetin e Kosovës në mbarë botën", thuhet në njoftim.



Mustafa: Kosova me rritje të ngadalësuar ekonomike, qeveria të koordinohet me aleatët

PRISHTINË, 28 PRILL - Kosova gjatë viteve të fundit ka shënuar rritje të ngadalësuar ekonomike. Anë, pse sipas qeverisë aktuale, ekonomia e vendit ka shënuar përparim me një rritje mesatare prej 7.9-përqindësh, ndonëse kjo rritje nuk po konsiderohet reale nga themeluesi i Institutit për Kërkim Zhvillimor "Riinvest", Muhamet Mustafa. Sipas tij, me rënien e investimeve dhe eksportit, ka bërë që vendi të ketë rritje të ngadalësuar ekonomike. Duke folur për faktorët që kanë goditur ekonominë e vendit, ai vlerëson se masat e vendosura nga Bashkimi Evropian karshi Kosovës duhet të hiqen sa më shpejt, për çfarë thotë se qeveria duhet të koordinohet me aleatët ndërkombëtarë sa më shumë.

Mustafa në një intervistë për "Kp" kërkon nga qeveria të lehtësojë me masa të ndryshme aktivitetet e bizneseve, po ashtu në këtë drejtim

të përmirësohet imazhi i vendit në mënyrë që të kemi më shumë investime të huaja.

Sa i përket klimës së të bërit biznes, Mustafa thotë se, pavarësisht prej premtimeve të qeverisë në këtë drejtim, ende nuk shihen rezultate konkrete sa i përket heqjes së barrierave në këtë drejtim.

"Klima e të bërit biznes, ne nuk kemi parë në raportin që kemi prezantuar përmirësim, ndoshta në disa ka mbetur situata e njëjtë. Shembull tek korrupsioni, tek transparenca, tek disa aktivitete të tjera, një diçka që e ka bërë qeveria, por që nuk është duke e zbatuar është lista prej rreth 28 pengesave administrative që i kanë bizneset dhe të fillojnë t'i heqin ato pengesa. Ne e kemi përhëndetur që është bërë ajo listë, por ende nuk është zbatimi dhe heqja e tyre, barrierave administrative që ua nxijnë jetën bizneseve", ka thënë Mustafa.

Ai tha se ende vendi përballat me



probleme në arsim, shëndetësi e të tjera. Sipas Mustafës, ka nevojë që qeveria t'i bazojë vendimet e veta në një evidencë më të mirë profesionale, shkencore e

kërkimore, po ashtu të krijojë bashkëpunim me institucionet arsimore.

Ndërsa shqetësuese mbeten edhe masat e BE-së ndaj Kosovës tash e

një kohë të gjatë. Mustafa derisa thotë se këto masa janë të padrejta, ai vlerëson se nevojitet me shumë koordinim nga qeveria me aleatët ndërkombëtarë.

Trajtimi i punëtorëve teknikë vazhdon të jetë shqetësues



PRISHTINË, 28 PRILL - Për kryetarin e Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemin, shqetësues vazhdon të mbetet trajtimi i punëtorëve teknikë të cilët janë kontraktuar nga kompani të ndryshme për të kryer punë në institucione shtetërore. Sipas Azemit, në sindikatën që ai udhëheq numri më i madh i ankesave përgjatë vitit të kaluar dhe këtij fillim viti kanë ardhur nga punëtorët teknikë, higjienikë e punëtorët e sigurimit të cilët janë kontraktuar për të kryer punë në institucione të ndryshme të shtetit.

"Kryesisht ankesat më të mëdha

kanë ardhur nga punëtorët të cilët në një farë forme kanë varshmëri nga pagesat që bëhen nga Qeveria e Kosovës. Për shembull, punëtorët teknikë të QKUK-së, në Universitetin e Prishtinës, punëtorët të cilët kryejnë punë për institucionet shtetërore, paguhen nga kompanitë private. Këtu e kemi gjendjen shumë të rëndë. Gjendje të cilën buxheti i shtetit këta punëtorë i paguan ende me pagë 250 euro. Këtu e kemi pasur fokusin më të madh. Këtu kemi pasur ankesa më të mëdha dhe këtu i kemi dënimet më të mëdha që ua bënë një shtet punëtorëve në sektorin privat të

Kosovës", ka thënë Azemi. Ndërsa kryeinspektori i Punës, Hekuran Nikçi, tregon se në Inspektoratin e Punës ankesat më të mëdha vijnë nga një tjetër kategori e punëtorëve në Kosovë. "Ankesat që ne i pranojmë më së shumti janë nga sektori i marketeve dhe gastronomisë. Pra, këta janë dy sektorët që prijnë me ankesa. Andaj ankesat që i pranojmë nga këta sektorë janë nga marrëdhënia e punës, shkëputja e njëanshme e kontratës së punës, mospagesë e orëve jashtë orarit, mospagesë e pushimeve vjetore e të lehonisë", ka thënë Nikçi.

"Çfarë është duke ndodhur në KEK? Ka rënie për 91.9 milionë euro", Shala i PDK-së kërkon llogari nga qeveria Kurti

Prishtinë, 28 prill - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka publikuar disa statistika të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ku tregohet se ka rënie të fitimit të kësaj kompanie publike. Ai ka kërkuar llogari dhe përgjegjësi

nga qeveria dhe Ministria e Ekonomisë. "Çfarë është duke ndodhur në KEK!? A ka llogaridhënie dhe kush duhet të japë përgjegjësi? Për cilën performancë na flet ministrja e Ekonomisë dhe qeveria? Nga 105.1 milionë euro fitim në vitin 2022, ka rënie për 91.9

milione euro në vitin 2023. Ky fitim minor prej 13.2 milionë eurosh, që është përgjysmë më i ulët edhe se në vitin e pandemisë 2020? PS: Të dhënat dhe shifrat e bazuara në raportin vjetor të KEK-ut për vitin 2023!", ka shkruar Shala në "Facebook".



Shfaqja që thërret njerëzoren!

EBI (Euro Ballkan Institute) në bashkëpunim me Teatrin "Dodona" dhanë premierën e shfaqjes "Shtëpia e nënës Elena" me tekst të Osman Gorancit dhe regji të Sevdije Ajetit.



Nga: Agron GËRGURI

Një lexim klasik mbase i duhur i tekstit të Osman Gorancit, që për temë ka trajtimin e të moshuarve të sëmurë në azil – gruan, intelektualizmin. Leximi regjisorial ishte i saktë dhe nxirrte atë që quhet nëntekst, duke dëshmuar gjuhën teatrore të cilën e kultivon regjisorja Sevdije Ajeti. Rrëfimi me nuanca sentimentale zhvillohet natyrshëm, edhe pse pa ndonjë ritëm të jashtëm, deri në momentin kur i vjen Deni (Arlind Islami), i biri i nënës Lena. Ardhja e tij si fikcion, në funksion të dramatizimit të situatës, sjell testin moral, sado që në aspektin dramaturgjik duket se vjen se ashtu do autori. Shpejtësia e pendesës për gjykimin e padrejtë ndaj nënës, kur ajo i prezanton dashnorin, nuk përkonte me rrjedhën e natyrshme të dramës – aq më tepër nuk e zbrëthente marrëdhënien e nënës së moshuar e të sëmurë për vdekje, e cila i kalon ditët e fundit në azil të pleqve, dhe të birit i cili nuk vjen ta vizitojë përveçse në ëndërr. Në fakt kjo skenë, ëndërr, ishte refleksion i realitetit të jashtëm

dhe si ndërgjegje e munguar. Personazhi ide, përveçse si test moral mbi trajtimin e të moshuarve në familje, nuk ka ndonjë pretendim tjetër. Në fakt, ëndërra është dritarja e hapur komunikimit me familjen në kohën kur asaj po i mbyllet dritarja e jetës të cilën mundohet ta mbajë hapur motra kujdestare (Valinë Muçolli), e cila përveçse i jep terapinë mjekësore, krijon batuta për t'i kthyer buzëqeshjen dhe ushqyer forcën për të përballuar sëmundjen përkundër së cilës ajo rrezaton me bukuri e mirësi. Në këtë mision vjen edhe personazhi i Dionit (Veton Osmani), si terapi dashurie, për t'ia bërë të përmbajtshme ditët e fundit të jetës, derisa si nëntekst alarmon trajtimin oportun të të moshuarve nga ana e familjarëve në këtë kohë që edhe dashuria na vjen e ambalazhuar me politikë interesi.

Regjisura konkrete dhe natyrshmëria e aktrimit

Regjisura e Sevdije Ajetit ishte ndërtuar me mizanakena spontane, pa veprime të

sforcuara, duke e konkretizuar mendimin e saj skenik me shenja të gjetura si kafja, libri, mollët, të cilat plotësonin dhe zbrëthenin gjendjen e personazhit kryesor të cilin e solli bukur dhe përmbajtshëm Zeta Bahtiri (Elena). Zeta Bahtiri e kishte shartuar mirë personazhin e Elenës përmes mimikës, gjestit, diksionit, shikimit dhe krijimit të marrëdhënive me personazhet tjera, me rekuizitat, ndërsa me veten intononte saktë duke na dhënë një kreacion të denjë. Personazhi i kujdestares mjekësore në interpretim të Valina Muçollit, i jep ngjyrimet e shfaqjes, pasuruar sa me batuta, sa me poezi antologjike të Preverit. Këtë personazh Valina Muçolli e solli me një natyrshmëri interpretuese që na bënte t'i besojmë Tandemi skenik Zeta Bahtiri dhe Valina Muçolli, në nivel aktrimit i kishin gjetur veprimet harmonike, në masë e pa patetikë, ku jo rrallë zhyten aktorët në role të tilla ku ka ngarkesë emocionale. Ato nxorën në pah karakteret e personazheve me nuanca të ndërtuara: gruan e

vetmuar, intelektualen, sëmundjen dhe dashurinë për jetën, kujdesin, dashamirësinë duke i dhënë kuptim secilit veprim fizik apo foljor brenda karakterit. Mbase ky ishte roli më i realizuar i Zeta Bahtirit në karrierën e saj aktorese. Veton Osmani (Dioni), kishte realizuar një karakter interesant të një njeriu që do jetën deri në frymën e fundit – i përkushtuar sado fatkeq. Me gje të vogla, mimikë miniaturiale e artikulum ndjesor shquhej shprehja e tij interpretuese. Si përplotësim i personazhit të Dionit vjen Vesa, në interpretim të Suela Konjarit, e cila sado në rol episodik tregon potencë interpretimi.

Muzika si ambientim dhe zbërthim emocional

Muzika ishte një prej elementeve më të realizuara të shfaqjes. Partiturat muzikore, përveçse e ambientonin shfaqjen, provokonin emocione, i zbrëthenin dhe përcillnin ndjenjat e personazhit në konceptin regjisorial. Tingujt e kompozuar të Agron Shalës depërtonin në thellësitë

shpirtërore të personazhit kryesor dhe integronin lojën e aktorëve në rrëfim, duke prekur përjetimin e spektatorit.

Mesazhi dhe përbërësit e tjerë të shfaqjes

Mesazhi që thërret njerëzoren dhe alarmon hendekun midis generatave, shprehet me (mos) kujdesin për të moshuarit të cilët kujtimet e ngrohtësisë familjare i bartin brenda vetes – të cilët e ruajnë shtëpinë e shpirtit, siç bën nënë Lena përmes së cilës ngrë shqetësim edhe angazhimi (i munguar) intelektual në jetën shoqërore. Kostumet e Samka Ferrit ishin të realizuara ashtu si edhe grimi shumë i mirë i Leonora Mehmetit – Hoxhës, dhe dizajnimi i ndriçimit nga mjeshtri Skender Latifi. Vlen për ta theksuar funksionalitetin e skenografisë së Jerina Hysajt e cila kishte bërë një përkufizim të saktë të hapësirës skenike! Kontribuues tjerë në realizimin e shfaqjes janë: asistentja e regjisë Anzotika Ana Ajeti, dhe puntorët e skenës: Bedri Maloku, Albert Gashi dhe Fadil Bekteshi./Telegrafi.

ALI AHMETI SHPALLET ‘QYTETAR NDERI’ I TIRANËS



Ismet SYLEJMANI

Ali Ahmeti emblema e madhe e politikantit integruar e fitimtar, progresiv e demokrat i popullit. Atdheut dhe Kombit, më 2 Maj 2024 Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Më 2 Maj 2024 në Kryeqytetin e Shqipërisë në Tiranë, Ali Ahmeti, Udhëheqësi i madh popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut, do të shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës! Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, politikani patriot, politikani atdhetar kombëtar, politikani që me fanatizëm, ka luftuar e lufton për çdo pëllëmbë të tokës shqiptare, për çdo të drejtë të çdo pjestari të popullit, Atdheut e të Kombit të tij shqiptar!

Askujt më mirë e më shumë, se sikur Ali Ahmetit, që është marrë me çdo gjë të popullit të tij, nuk i shkon Shpallja “Qytetar Nderi” më 2 Maj 2024, i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Biri i madh, Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton gjithëçka të mirë të popullit, Atdheut e Kombit të Tij, sepse një jetë të tërë, ka qëndruar në nivel e i gatshëm për të kryer çdo detyrë në shërbim të çështjes shqiptare, të lirisë dhe të Pavarësisë së Kosovës nga Serbia pushtuese!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, veprimtari i shquar politik kombëtar, më 2 Maj 2024 do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, ish – i burgosuri politik në Kosovë, pas ngjarjeve të të vitit 1981, që ka vuajtur burgun në burgun e Smrekovnicës në Vushtrri, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, ilegali i madh politik kombëtar, më 2 Maj 2024 do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, drejtuesi shumëvjeçar i LPRK-LPK-së, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, luftëtari, ushtari e komandanti lavdimadhi i çlirimtar të

Kosovës dhe Viseve të saja nën ish-jugosllavi, nga Serbia pushtuese, më 2 Maj 2024 do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, ish-Anëtar i Shtabit Qendror të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, më 2 Maj 2024 do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇPMB-së, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, Përfaqesuesi Politik i UÇK-së në Maqedoninë e Veriut, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skenderbeu të Kuvendit të Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, politikani më i famshëm pas vitit 2000, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, politikani më i famshëm pas vitit 2000, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, praktikues largpamës i Programit liriadshës, luftarak e çlirimtar të Lidhjes Shqiptare të Prizerenit, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, mbajtës i fuqishëm e me duar të hekurta të flamurit kombëtar shqiptar, i cili pas Skënderbeut, për herë të parë u valëvit nga duart e Plakut të Pavarësisë së Shqipërisë, i urti Ismail Qemali, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, mbajtës i fuqishëm e me duar të hekurta të flamurit kombëtar shqiptar, i cili pas Skënderbeut, për herë të parë u valëvit nga duart e Plakut të Pavarësisë së Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, drejtuesi shumëvjeçar i LPRK-LPK-së, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, luftëtari, ushtari e komandanti lavdimadhi i çlirimtar të

Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, emblema e atdhetarit më të përsosur, që me pjesmarrjen dhe ndikimin e Tij direkt, ka shtrirë kudo dorën e Tij të artë organizative dhe mendjen e Tij të mprehtë, të shëndoshë e atdhetare, dhe ka kapur dhe mbajtur fuqishëm çdo fije të çështjes së çlirimtar të popullit shqiptar nga Serbia pushtuese, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skenderbeu të Kuvendit të Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin e Pavarësisë së Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin e Ushtrisë së Shtetit të Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin e Shtetit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin e Shtetit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit



shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, shoku e bashkeveprimtari i dhjetra, qindra e mijëra aktivistëve, veprimtarëve, atdhetarëve, patriotëve, ish-të burgosurve politik, politikaneve ilegal atdhetar dhe i një kontigjenti të pafund të erupsionit zingjiror që shpërhente dhe rrjedhte si llavë vullkani në shërbim të çështjes kombëtare e të përgaditjes së luftës për çlirim të Kosovës nga Serbia pushtuese, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Pas burgosjeve të udhëheqjes së lartë ilegale të ngjarjeve të mëdha të pranverës së kuqe të vitit 1981, Udhëheqësi i madh popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, që zëvendësoi me madhësi të profesionalizëm Sekretarin Organizativ, ilegalin e madh me megafon Hydajet Hysenin, më 2 Maj 2024, do të Shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës, Kryeqytetit të Nënë Shqipërisë!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës! Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

Udhëheqësi i madh i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, meriton dekoratën dhe nderimin Gjergj Kastrioti Skënderbeu të Kuvendit të Kosovës!

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Dy ekipet nga Ferizaj kampion të Kupës së Kosovës në hendboll

FERIZAJ, 28 PRILL - Të dielën u zhvilluan ndeshjet finale të Kupës së Kosovës në hendboll. Të dy ndeshjet ishin plot emocione dhe dhuruan atmosferë të

veçantë për publikun. Në konkurrencën e femrave u shpall kampion Ferizaji, ndërsa në konkurrencën e meshkujve Kastrioti. Kupën për klubin e Ferizajit, në

konkurrencën e femrave e ndau kryeministri Albin Kurti, ndërsa medaljet për ekipin zëvendësministria e MKRS, Daulina Osmani. Ndërsa në konkurrencën e

meshkujve, Kupën e ndau kryetari i FHK-së, Eugen Saraçini. Urime të dy ekipeve për fitoren dhe përgëzime Federatës së Hendbollit të Kosovës për organizimin.



Fitojnë Ballkani e Llapi, dështon Drita

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 PRILL - Ballkani dhe Llapi kanë shënuar fitore të dielën, kurse Drita është ndalur në barazim duke bërë një hap pas në garën për titull të kampiones në Superligë. Ballkani e mposhti në udhëtim Gjilanin me rezultat 0-2, në kuadër të javës së 31-të në Superligë. Golat e fitores për skuadrën lidere dhe kampiones shënuan Nazmi Gripshi dhe Lumbarth Dellova. Pas kësaj fitore, Ballkani është në vend të parë me 63 pikë, kurse Gjilani mbetet i shtati me 34 pikë. Fitore me rezultat identik realizoi edhe skuadra e Llapit në përballje me Prishtinën. Të dy golat për ekipin e drejtuar nga Tahir Batatina i realizoi Muhamet Hyseni.

Llapjanët tani kanë 61 pikë, kurse Prishtina zë vendin e pestë me 43 pikë. Ndryshe nga këto dy skuadra që shënuan fitore, Drita është dashur të kënaqet me një pikë në ndeshjen ndaj Dukagjinit (1-1). Një autogol i Vitor Hugos ia dha epërsinë gjilanasve, teksa vendasit barazuan në fundin e ndeshjes përmes Granit Elezajt. Drita është e treta në tabelë me 59 pikë, kurse Dukagjini është i gjashti me 39 pikë. Të shtunën Liria e ka befasuar Fushë Kosovën, në kuadër të xhiros së 31-të. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, u mbyll me rezultat 2-0, në favor të prizrenasve. Kjo humbje i vështirëson edhe më shumë Fushë Kosovës luftën për t'iu shmangur rënies nga elita, kur kanë mbetur edhe pesë javë deri



në përfundim të kampionatit. Golat për Lirinë i shënuan Aldi Gjumsi, në minutën e tretë dhe Ubong Ekpai, në minutën e 30-të. Fitore tejet të rëndësishme në luftën për mbijetesë në elitë ka realizuar Feronikeli 74, që në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas e ka mundur Malishevën,

me rezultat 2-1. Florent Avdyli në minutën e 61-të shënoi për epërsinë e vendësve. Rezultatit e barazoi Drilon Hazrollaj nga penalltia, por dhjetë minuta para përfundimit të ndeshjes fitoren për vendasit e siguroi Ibrahim Cërvadiku. Pas kësaj fitoreje Feronikeli 74 tani ka 34 pikë në

SUPERLIGA		
Dukagjini - Drita		1-1
Gjilani - Ballkani		0-2
Prishtina - Llapi		0-2
Feronikeli - Malisheva		2-1
Fushë Kosova - Liria		0-2
Tabela		
	Pikë	Pikë
1. Ballkani	31	63
2. Llapi	31	61
3. Drita	31	59
4. Malisheva	31	52
5. Prishtina	31	43
6. Dukagjini	31	39
7. Feronikeli	31	34
8. Gjilani	31	34
9. Fushë Kosova	31	20
10. Liria	31	10

vendin e tetë, aq sa ka edhe Gjilani në vendin e shtatë, por me një ndeshje më pak.

Trepça kualifikohet në finale, Peja ngushton epërsinë ndaj Prishtinës

"Epoka e re"

MITROVICË, 28 PRILL - KB Trepça është kualifikuar në finale të "play-off"-it në Prince Caffè Superligë. Mitrovicasit në ndeshjen e tretë të serisë gjysmëfinale shënuan fitore ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 82:69 (24:19, 21:12, 18:18, 19:20). Pas një fillimi të barabartë, mitrovicasit u shkëputën deri në dhjetë pikë epërsi, 24:14, por me pesë pikë radhazi nga prishtinasit, çereku i parë përfundon 24:19. "Xehetarët" vazhduan me lojë të mirë në periudhën e dytë, për tu shkëputur më shumë, ku epërsia më e thellë ishte 16 pikë, 38:22, derisa pjesa e parë përfundoi 45:31. Perioda e tretë ishte më e barabartë, me



bardhekaltrit që tentuan të afrohen në rezultat dhe mitrovicasit që ruajtën epërsinë

e krijuar, derisa shifrat pas 30 minutash ishin 63:49. Në dhjetë minutat e fundit, kryeqytetasit

ngushtuan shifrat në 75:67, megjithatë, Trepça sërish u shkëput dhe triumfoi në fund 82:69. Më i miri te Trepça ishte Brandon Edwards me 20 pikë e 12 kërcime, derisa te Sigal Prishtina, Donte Clark dhe Malcolm Armstead shënuan nga 16 pikë. Trepça në finale e pret fituesin e ndeshjes Peja-Golden Eagle Ylli, ku rezultati momental është 1:2 për therandasit. Ndërsa Peja ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 98:86 (25:23, 27:21, 26:19, 20:23), për të ngushtuar serinë gjysmëfinale të "play-off"-it në 2:1. Çereku i parë ishte kryesisht i baraspeshuar, ku herë njëra skuadër ishte në epërsi e herë tjetra, derisa epërsinë më të lartë e kishin therandasit 11:16, kurse kjo pjesë përfundoi 25:23. Kampionët e Kosovës ishin më

të mirë në periudhën e dytë, duke pasur epërsi tri herë deri në 11 pikë, ndërsa shkuan në pushim me rezultat 52:44. Pejanët vazhduan me lojë të mirë në periudhën e tretë, për të ngritur më shumë epërsinë, ku më e larta ishte 21 pikë, 73:52, derisa shifrat pas 30 minutash ishin 78:63. Në dhjetë minutat e fundit, therandasit tentuan rikthim, por Peja menaxhoi epërsinë dhe lojën, duke triumfuar në fund 98:86. Te Peja më i miri ishte Larry Thomas me 27 pikë, katër kërcime e nëntë asistime, kurse te Golden Eagle Ylli më i miri ishte Alonzo Verge Jr me 32 pikë, nëntë asistime dhe gjashtë topa të vjedhur. Ndeshja e ardhshme zhvillohet në mesjavë në Therandë, derisa skuadra që shënon tri fitore kualifikohet në finale.

PSG-ja fiton titullin e 12-të në Francë

PARIS, 28 PRILL - Paris Saint-Germain është zyrtarisht kampion i Francës. Parisienët festuan titullin e tretë radhazi dhe të 12 në histori. Pas humbjes 3-2 të Monaco-s në transfertën e Lyonit, PSG-ja është matematikisht kampion i Ligue 1 për sezonin 2023-2024.

Titulli i parë për Luis Enriquen në Francë, me spanjollin që u rikthye te një titull pas sezonit 2015-2016 kur triumfoi në La Liga me Barcelonën. Në 12 vite, prej 2012-ës, ky ishte titulli i dhjetë për Paris Saint-Germain që nuk ka triumfuar në vetëm dy sezone 2016-2017

(Monaco) dhe 2020-2021 (Lille). Ky ishte trofeu i dytë sezonal për parisienët, pas Superkupës së fituar në fillim të këtij viti ndaj Toulouse, teksa PSG-ja është në lojë edhe për dy trofe të tjerë, me finalen e Kupës ndaj Lyonit dhe Ligën e Kampionëve.





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

